



## **Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”**

### **Fakulteti i Edukimit**

#### **Programi Master: Pedagogji**

### **Kursi: Metodatat e hulumtimit kualitativ**

**Mësimdhënësi: Dr. Blerim Saqipi**

**Orari i mësimi:**

**Salla:**

**Kontakti: [blerim.saqipi@uni-pr.edu](mailto:blerim.saqipi@uni-pr.edu)**

#### **Përshkrimi i Kursit:**

Qëllimi i kursit është të njihen studentët me përdorimin e metodave kualitative (cilësore) në fushën e arsimit. Kursi ka fokus teorik dhe aplikativ. Së pari do të shqyrtohet mënyrat e zbatimit të metodave kualitative në fushën e arsimit. Kursi do të shtjelloj metodologjinë kualitative si qasje interpretative duke u fokusuar në zhvillimin dhe përdorimin e teorisë, mbledhjen dhe analizën e të dhënave. Studentët do të kenë mundësinë të ekspozohen ndaj qasjeve të ndryshme të realizimit të një studimi kualitativ si dhe do të kenë mundësinë e analizës kritike të shembujve të artikujve të ofruar. Në anën tjetër studentët do të kenë mundësinë e zhvillimit të një projektpropozimi në fushën e arsimit duke adresuar të gjitha elementet e një studimi përmes tij. Në këtë mënyrë ata do të kenë mundësinë të lidhin aspektet teorike dhe praktike të realizimit të një studimi kualitativ.

#### **Rezultatet e pritura**

Në fund të kursit studentët do të jenë në gjendje:

- a. identifikojnë komponentet e ndryshme të hulumtimeve kualitative duke përfshirë: qasjet teorike, shqyrtimi i literaturës, qasjet në mbledhjen e të dhënave, kodimi, interpretimi i rezultateve dhe raportimi.
- b. spjegojnë implikimet e hulumtimeve kualitative në procesin arsimor.

- c. hartojnë projektpropozimet e tyre duke reflektuar për zgjedhjen teorike, literaturën, metodat dhe mbledhjen e të dhënave dhe hapat e tjerë (të natyrës kualitative).

Java	Tema	Literatura	Detyrat
1	Hyrje në kurs Prezantimi i sillabusit dhe detyrave		
2	Natyra e hulumtimit (ontologjia dhe epistemologjia) + Definimi i problemit	1 A1 & 1 A2	Identifikimi i një problemi + Përcaktimi i qasjes
3 & 4	Modelet dhe llojet e hulumtimeve kualitative  Kriteret e cilësisë në hulumtimet kualitative	1 B3 & 1B4	Përcaktimi i modelit
5	Dizajni (pyetja e hulumtimit), mostra dhe etika e hulumtimit	P1 Pjesa B dhe në veçanti B5 + 1 A5	Përcaktimi i dizajnit  Analiza kritike e artikullit (10%)
6.	Roli i teorisë dhe pasqyra e literaturës	1 B2	Identifikimi i literaturës për studimin
7	Mbledhja e të dhënave: Intervista + Grupi i fokusit	1 C4 & 1 C5	Identifikimi i instrumenteve & mbledhja e të dhënave
8	Mbledhja e të dhënave: Vëzhgimi, të dhënat rrëfyese dhe analiza e dokumenteve	1 C6 deri 1 C8	Identifikimi i instrumenteve + mbledhja e të dhënave
9	Testi I		10%
10&11	Analiza e të dhënave kualitative	1 D4 deri 1 D8	Përshkrimi i metodës së analizës cilësore
12	Hartimi i projektpropozimeve	1 B	Projektpropozimi (20+10 = 30%)
13	Raportimi i hulumtimeve kualitative	1 E	
14	Përmbyllje		

## Vlerësimi

Puna e studentëve do të vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në njohuritë për aspektet teorike, shkathësitë dhe kreativitetin në prezantim, shkrimin reflektiv të bazuar në analizën e artikujve dhe punën hulumtuese. Nota në kurs bazohet në performancën e studentëve në aktivitetet vijuese:

Detyrat:	Përqindja e përfshirë në notë
Analiza 'kritike' e artikullit	10%
Testi I	10%

Projektpropozimi i hulumtimit	20%
Prezantimi i projektit hulumtues	10%
Provimi përfundimtar	50%
<b>Totali</b>	<b>100%</b>

Nota përfundimtare

Pikët	Nota
90-100 %	10
80- 89 %	9
70- 79 %	8
60- 69 %	7
55-59 %	6

### **Rregullat për studentë:**

Çdo student duhet të:

1. Lexoj literaturën e kërkuar dhe artikujt e sugjeruar, të marrë pjesë në diskutimet në klasë, të përgatitet për provimin përfundimtar dhe për të gjitha aktivitetet tjera të klasës.
2. Përgatisë dhe të dorëzoj të gjitha detyrat në kohën e duhur. Çdo vonësë do të ndëshkohet me pikë të humbura.
3. Përdorë stilin APA në të gjitha detyrat e shkruara (shih shembuj në Doracakun për Tezën e Masterit)
4. Kuptojë se nuk lejohet kopjimi dhe plagjiatura.
- 5 Kuptojë se gjatë orëve mësimore nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë dhe ardhja me vonesë apo largimi nga ora pa arsye.
6. Viojë me rregull ligjëratat dhe ushtrimet.

### **Literatura**

#### **Literatura bazë:**

[1] Mattheus, B. & Ross, L.(2010). Metodatat e hulumtimit. Udhëzues praktik për shkencat sociale e humane.(e. Qendra për Arsim Demokratik (CDE) Tiranë.

#### **Literatura shtesë:**

Kumar, R. (2014). *Metodologjia e hulumimit: udhërrëfyes hap pas hapi për fillestarë*. Sage Publications.

Cresswell, J. W. (2007). *Qualitative inquiry and research design: Choosing among five traditions*. Thousand Oakes, CA: SAGE Publications.

Vërejtje: Gjatë shkrimit të punimeve sugjerohet zbatimi i stilit APA të referencave (<http://www.apastyle.org/>).